

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder tregon detyrat: Kapitujt duhen mbyllur. Rama: Europa mos të n a lërë në baltë, do jetë dështim
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/konferenca-nderparlamentare-schieder-tregon-detyratkapituj t-duhen-m-i516470
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 09:55:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 09:31:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	49101ecfbc81db1baeeaccbaab71b9da2a638807f4f0a640273483877f24a990
TEKSTI	b2a0e06bcb2b009564db6b1972d4c2c31995427dd063ce75ebe2dd58ab90b527
PAMJA	c4167b6ff1eafea083fdcc42cfcec127fe4b8454045cca38bfffade7be0a9ca0b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0418adc1b6e64ac3ec5b1fd3dc0d03c8de6adf1f244143d4a373009d37eb5f89
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	abea285c66b625fda61d55a4ce47e92e047f4e5aa34cb0aedb7a5ee71b2cb2e0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/0418adc1b6e64ac3ec5b1fd3dc0d03c8de6adf1f244143d4a373009d37eb5f89

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

9 MINUTA ME PARE

Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder tregon detyrat: Kapitujt duhen mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në baltë, do jetë dështim

1 ORE ME PARE

Përfundon mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, në fokus hetimi ndaj ish-drejtoreshës së SHISH dhe sigurisë e informacionit të klasifikuar

16 ORE ME PARE

120 ditë protestë/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, me thirrje e pankarta në duar: Rama jep dorëheqjen

19 ORE ME PARE

Kryeministri anuloi konferencën me gazetarët, Berisha: Kapitullim pa kushte i Ramës. Bardhi: Përgjegjësia nuk shmanget

LIVE UPDATES

Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder tregon detyrat: Kapitujt duhen mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në baltë, do jetë dështim

• Ditën e sotme u zhvillua në Tiranë Konferenca Ndërqeveritare me temë "Agjenda strategjike për zgjerimin e BE-së dhe anëtarësimin e Shqipërisë", ku morë pjesë përfaqësues të institucioneve shqiptare dhe Parlamentit Evropian. • I pari që mori fjalën ishte Kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi, i cili deklaroi se procesi i integritimit evropian i Shqipërisë nuk duhet të mbështetet vetëm te institucionet politike, por edhe te mbështetja e qytetarëve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. • Peleshi theksoi rëndësinë e diplomacisë parlamentare dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, duke shtuar se duhet vijuar puna për të rritur mbështetjen e publikut në vendet anëtare për zgjerimin e BE-së. • Kryeministri Edi Rama nisi fjalën e tij me batuta duke deklaruar se preferon që të flasë vetë anglisht pasi nuk ka besim te përkthyesit. • Në fjalën e tij, Rama u kërkoi ndjesë të pranishmëve për vonesën, duke thënë se ishte për shkak të një takimi me Bajram Begajn. • Ai sërish sulmoi protestuesit duke thënë se flamingot nuk nuk duken aq bukur sa në foto. • Rama e cilësoi protestën e qytetarëve shqiptarë të cilët prej tre muajsh po protestojnë kundër tij, si një moment të bukur që po kalon vendi. • Më tej, ai u ndal edhe tek integrimi i vendit në Bashkimin Evropian. • Në lidhje me këtë ai argumentoi se Shqipëria mbetet plotësisht e angazhuar në procesin e integritimit dhe dëshiron të bëhet pjesë e saj sa më shpejt të jetë e mundur. • Lideri i qeverisë i bëri gjithashtu thirrje Bashkimit Evropian që të mos e lërë pas dore Ballkanin Perëndimor, pasi sipas tij një skenar i tillë do të kishte pasoja të mëdha për vetë Evropën. • Rama tha se vendimet politike nuk duhet të shtyhen për momentin e fundit, ndërsa reformat dhe proceset e integritimit të vijnë në bazë të meritave të secilit vend kandidat. • Duke iu referuar rënies së Murit të Berlinit, kryeministri theksoi se Europa ka nevojë për një sinjal të fortë se vendet e kontinentit janë bashkë. • Ai përdori edhe metaforën e "shtatë fëmijëve" të Ursula von der Leyen, duke iu referuar shtatë vendeve candidate për anëtarësim në BE dhe nevojës që ato të jenë pjesë e së njëjtës tryezë europiane. • Raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Andreas Schieder ka treguar detyrat që Shqipëria duhet të bëjë në mënyrë që të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian. • Ai tha se zgjerimi i Bashkimit Evropian nuk duhet parë vetëm si një projekt për të ardhmen, por si një proces që i përket të gjithë kontinentit. • Schieder theksoi se çështja nuk qëndron vetëm tek hapa e kapitujve, por tek mbyllja e tyre, duke shtuar se reformat duhet të jenë pjesë e shoqërisë. • Ndërsa, Ambasadorja e re e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Sofia Moreira de Sousa, deklaroi se Shqipëria ka bërë hapa konkretë në rrugën drejt anëtarësimit në BE. • Gjatë fjalës së saj në Konferencën Ndërparlamentare, ajo vlerësoi përparimin në sundimin e ligjit, forcimin e institucioneve gjyqësore, kuadrin ligjor, të drejtat e njeriut dhe reformat ekonomike.

7 artikuj për këtë temë.

22 MINUTA ME PARE

Ambasadorja e re e Bashkimit Evropian mesazh të qartë: Shqipëria të ketë institucione demokratike



editoriale

Enton Abilekaj

Labirinti i errët i Edi Ramës

Auron Janku

"Washingtonët" tanë



Sofia Moreira de Sousa

TIRANË- Ambasadorja e re e Bashkimit Europian në Shqipëri, Sofia Moreira de Sousa, deklaroi se Shqipëria ka bërë hapa konkretë në rrugën drejt anëtarësimit në BE. Gjatë fjalës së saj në Konferencën Ndërparlamentare, ajo vlerësoi përparimin në sundimin e ligjit, forcimin e institucioneve gjyqësore, kuadrin ligjor, të drejtat e njeriut dhe reformat ekonomike.

Ajo theksoi se, pavarësisht arritjeve, puna duhet të vijojë, duke kërkuar që fokusi të mbetet te rezultatet konkrete për qytetarët.

“Nuk ka vend më të mirë për të diskutuar zgjerimin sesa mes deputetëve, sepse zgjerimi është projekt politik. Integrimi është një projekt që bën bashkë popujt e ndryshëm. Shqipëria ka hapur 6 grup-kapituujt. E ardhmja europiane e Shqipërisë po bëhet gjithmonë e më shumë e prekshme. Reforma në drejtësi është një reformë që ka ndihmuar në forcimin e drejtësisë. Shqipëria ka ecur në kuadrin ligjor për të drejtat e njeriut, mbrojtjen ndaj dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtjen e të dhënave. Me Planin e Rritjes së BE-së, Shqipëria po përfiton nga disa prej mundësive që aktualisht i kanë edhe vendet anëtare. Për ne, kyçe është që qytetarët shqiptarë të ndjejnë procesin e anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Ne jemi të interesuar që Shqipëria të ketë institucione demokratike. Kuvendi ka një rol kyç në procesin e integritimit të vendit në BE, sepse Kuvendi është zëri i qytetarëve dhe ofron mundësinë që të debatohen vendimet politike. Kjo është shumë e rëndësishme kur Shqipëria dëshiron të ecë përpara me reformat. Duhet të përshihet e gjithë shoqëria në integrim. Ne këtu jemi duke shkëmbyer përvojën, njohuritë dhe përditësinë e punës sonë. Rrugëtimi i Shqipërisë në BE e ka shndërruar vendin, por ky shndërrim duhet të vazhdojë. Qytetarët për dekada të tëra i kanë dhënë besimin e tyre BE-së. Destinacioni është më shumë se anëtarësimi, por është një Europë më rezistente ndaj kërcënimeve,” tha ajo./Dosja.al

27 MINUTA ME PARE


“Nuk mërzitem kurrë me Shqipërinë”, Rama ndërpret fjalën e raportuesit për Shqipërinë në PE: Aman, s’i lë dot gjermanët të presin



Andreas Schieder dhe Edi Rama

TIRANA- Raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Andreas Schieder deklaroi gjatë fjalës së tij në Konferencën Ndërparlamentare se po të flasësh për shtetin tonë, nuk mërzitesh asnjëherë.

“Të mërzitesh prej Shqipërisë nuk ndodh, sepse ofron kaq shumë mundësi”, tha ai.



Në vëmendje

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 11:21

“Nuk mërzitem kurrë me Shqipërinë”, Rama ndërpret fjalën e raportuesit për Shqipërinë në PE: Aman, s’i lë dot gjermanët të presin

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 10:39

Kriza e heshtur/ FMN: Shqipëria po diplomon studentë që nuk i duhen kujt, e fundit në rajoni për studentët e shkencës

BOTA 28 SHTATOR 2026, 09:21

Analiza e DW: Me çfarë idesh Evropa synon të kapërcejë krizën e banesave?

më të klikuarat



Rama sulmon 2 televizione: Lavatriçe mediatike, kanë marrë peng një Prokurori

Labirinti i errët i Edi Ramës



Çfarë po ndodh në Rinas? Rama lë gazetarët jashtë dhe anulon konferencën, video-mesazhi shpërndahet me regji nga Kryeministria

Reforma në Drejtësi/ Rama: Pa mua, SHBA-ja dhe BE-ja do kishin bërë Noc Rrokun

insights

Bledian Koka

Pse Rama i denoncoi

shqiptaret si
antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në
kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim
po ndërtohet një
pallat

Auron Janku
Kur PARTITË
harrojnë pse
ekzistojnë

Moti

Powered by  tomorrow

Ndërsa raportuesi vijonte fjalën e tij, kryeministri Edi Rama ndërhyri me një batutë, duke kërkuar që diskutimi të mos zgjatej shumë, pasi kishte një takim të planifikuar me përfaqësues gjermanë.

"Kërkoj ndjesë se kam një takim me gjermanët dhe nuk i lë dot të presin. Aman, mos ia përmend Greqinë sot, se Gjermania humbi dje 1-0 ndaj Greqisë", tha me humor Rama, ndërsa Schieder vijoi fjalën./Dosja.al

42 MINUTA ME PARE

“Ursula s’i tha vajzës shko luaj me gangsterin rus”/ Rama: Europa ka shtatë kandidatë, mos na lini në baltë



Edi Rama

TIRANË- Kryeministri Edi Rama u ndal te procesi i integrimit evropian dhe nevoja për një qasje më të shpejtë politike ndaj zgjerimit. Në fjalën e tij në Konferencën Ndërparlamentare për zgjerimin e BE-së, Rama tha se vendimet politike nuk duhet të shtyhen për momentin e fundit, ndërsa reformat dhe proceset e integrimit të vijojnë në bazë të meritave të secilit vend kandidat.

Duke iu referuar rënies së Murit të Berlinit, kryeministri theksoi se Europa ka nevojë për një sinjal të fortë se vendet e kontinentit janë bashkë. Ai përdori edhe metaforën e “shtatë fëmijëve” të Ursula von der Leyen, duke iu referuar shtatë vendeve kandidate për anëtarësim në BE dhe nevojës që ato të jenë pjesë e së njëjtës tryezë europiane.



"Shpresoj që të gjithë, pavarësisht zellit apo ngurrimit, të gjejnë rrugën për t'i dhënë botës dhe Europës një sinjal shumë të fortë. Nuk është e vështirë një rrugë e tillë, është e thjeshtë, është si veza e Kolombit apo ajo e Helmut Kolnit kur ra muri. Ai nuk i shkoj Lindorëve t'i tregonte kapituj e shumtë për të plotësuar, por i tha: Ne jemi bashkë. Ende mund të shohësh dallime, ama çfarë mund të ndryshojë dhe lehtësojë është që vendimet politike të mos lihen në momentin e fundit.

Të merren tani dhe më pas të plotësohen proceset sipas meritave. Shtatë fëmijë ka Ursula dhe Europa ka shtatë kandidatë. Fëmijët e Ursulës u rritën në tavolinë, ajo nuk i tha vajzës shko rri me atë gangsterin rus apo vajzës të luajë me ato lodrat kineze. Ata ishin të gjithë në atë tavolinë, pavarësisht se fjala nuk i peshon te gjithëve njësoj, apo të gjithë hanë diçka.

Prandaj të gjithë duhet të jenë aty, siç thotë Helmut Koln. Nëse ti plotëson një kapitull, je anëtar për atë kapitull. Nëse nuk ke plotësuar një tjetër kapitull, je si fëmija i Ursulës. Ne shumë gjëra i kemi të përbashkëta. Nuk duhet të kujtohem se jemi një kur kemi vetëm ndonjë sulm, a valë emigracioni. Është si veza e Kolmbit, shumë e thjeshtë, siç thotë kompania Nike: Bëjeni," tha Rama./Dosja.al

42 MINUTA ME PARE

Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder tregon detyrat: Kapitujt duhen mbyllur, reformat të jenë pjesë e shoqërisë



Andreas Schieder

TIRANA- Raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Andreas Schieder ka treguar detyrat që Shqipëria duhet të bëjë në mënyrë që të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian. Gjatë fjalës së tij në konferencën Ndërparlamentare e cila po zhvillohet në Tiranë, ai tha se zgjerimi i Bashkimit Evropian nuk duhet parë vetëm si një projekt për të ardhmen, por si një proces që i përket të gjithë kontinentit.

Ai theksoi se çështja nuk qëndron vetëm tek hapja e kapitujve, por tek mbyllja e tyre, duke shtuar se reformat duhet të jenë pjesë e shoqërisë. Në fund, Schieder deklaroi se Shqipëria ndodhet në fund të garës dhe meriton të jetë anëtare e re e BE.

Andreas Schieder: Ende besoj se zgjerimi i BE nuk është vetëm projekt i së ardhmes por e meriton i gjithë kontinenti. Dua të jap edhe unë kontributin tim për ta finalizuar këtë moment historik. Këtu në Shqipëri kemi 95 % të popullatës që është pro

BE, Shqipëria është pararendësja e procesit të zgjerimit siç ka thënë Marta Kos. Raporti i sivjetshëm është votuar me një shumicë të madhe dhe kjo tregon që të gjithë e shohin përparimin e bërë nga Shqipëria. Shqipëria vite më parë ndërmoi proces të vështirë, si vetting, reforma ekonomike reforma në drejtësi, siguria dhe politika e jashtme ku Shqipëria është plotësisht në përputhje me BE. Tani ndodhemi në fazën e fundit të garës. Pra nuk është çështja që vetëm të hapen kapituj por edhe të mbyllur. Shqipëria meriton të jetë anëtare e re e BE./Dosja.al

50 MINUTA ME PARE

Konferenca Ndërparlamentare/ Rama: Shpresojmë që BE të mos e lërë sërish në baltë Ballkanin Perëndimor



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.